



AUTORITETI RREGULLATIV I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
REGULATORNI AUTORITET ZA ELEKTRONSKE I POŠTANSKE KOMUNIKACIJE
REGULATORY AUTHORITY OF ELECTRONIC AND POSTAL COMMUNICATIONS

Nr. prot. 048/B/19

Datë: 08 Maj, 2019

KONKLUZIONE

NGA

KËSHILLIMI PUBLIK I DOKUMENTIT

“PLANI PËR HAPJEN E BREZEVE”

Dokumenti ‘Plani për hapjen e brezeve’ është përgatitur mbështetur në nenin 3, paragrafët 1) dhe 2), nenit 9, paragrafi 3.6), nenit 10, paragrafi 4) dhe 12), nenit 45 paragrafët 1) dhe paragrafi 2), nenit 54 paragrafi 1), paragrafi 2) dhe paragrafi 4), nenit 79 paragrafët 1) dhe 2) dhe neni 82 paragrafi 1) dhe 3) të Ligjit për Komunikimet Elektronike Nr. 04/L-109 (tutje referuar si – Ligji ose LKE) dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (tutje referuar si – Autoriteti ose ARKEP).

Sipas Vendimit Nr. 1196 (Ref. ARKEP Nr. Prot. 032/B/18)¹ të datës 23 Maj 2018, ARKEP ka miratuar fillimin e procedurës së Konsultimit Publik të dokumentit² të referuar më lartë nga data; **23 Maj 2018** deri më datë; **06 Korrik 2018**. Pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit IPKO Telecommunications LLC (tutje referuar si – IPKO), ARKEP me Vendimin nr.1225 (Ref. Nr.Prot. 037/B/18)³ të datës 04 Korrik 2018 ka vazhduar procesin e konsultimit publik deri më datë **01 Gusht 2018**.

Gjatë periudhës së Konsultimit Publik, komente kanë dërguar operatorët si në vijim:

- 1) **Komentet e Telekomit i Kosovës sh.a.** - janë dërguar më datë 01 Gusht 2018 (Ref. ARKEP Nr. Prot.576/2/18),

¹ <http://www.arkep-rks.org/?cid=1,26,1079>

² <http://www.arkep-rks.org/?cid=1,13,1077>

³ <http://www.arkep-rks.org/?cid=1,26,1091>

- 2) **Komentet e IPKO-së** - janë dërguar më datë 01 Gusht 2018 (Ref. ARKEP Nr. Prot.572/2/18),
- 3) **Komentet e Dardafon.Net** - janë dërguar më datë 01 Gusht 2018 (Ref. ARKEP Nr. Prot.575/2/18), dhe
- 4) **Komentet e mts D.O.O.** – janë dërguar më datë 25 Korrik 2018 (Ref. ARKEP Nr.Prot. 557/2/18).

Gjithashtu komentet e operatorëve janë analizuar edhe nga kompania e specializuar ndërkombëtare “Plum Consulting” të angazhuar në procesin e vlerësimit të brezeve frekuencore me vlerë të posaçme ekonomike për shërbimet IMT.

Bordi i Autoritetit pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga operatorët, në mbledhjen e 39-të me radhë të mbajtur më datë 07 Maj 2019 ka miratuar “Planin për Hapjen e Brezeve” së bashku me përgjigjet/qëndrimet e ARKEP ndaj komenteve të dërguara, të cilat në mënyrë të përmbledhur janë paraqitur në tabelat si në vijim (Shtojcat I, II, III dhe IV).

Dokumenti final “**Plani për Hapjen e Brezeve**” së bashku me përgjigjet e ARKEP publikohen në web faqen: www.arkep-rks.org.

Përgjigjet e ARKEP ndaj komenteve të operatorit 'Telekomi i Kosovës'

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e Telekomit të Kosovës sh.a.	Përgjigja e ARKEP
/	Koment i përgjithshëm	<p>...ARKEP duhet të ofrojë frekuencat për përdorim në kushte sa më të favorshme. Nëse ofrohet një procedurë lehtësuese dhe një çmim më i ulët sesa në procedurat paraardhese, kjo do t'i vendos operatorët në pozitë më të favorshme ekonomike dhe do të promovohet një konkurrencë efektive...</p>	<p>Marr parasysh nevojën e operatorëve në treg për resurse frekuenore, politikat e sektorit të komunikimeve elektronike si dhe objektivat për zhvillimin e rrjetave brezgjera, ARKEP ka angazhuar një kompani konsulente nderkombetare, e specializuar në fushën e komunikimeve elektronike me fokus të veçantë në çështjen e vlerimit dhe mënyrës së dhënjes së spektrit.</p> <p>Qëllimi i angazhimit të kësaj konsulence është vlerimi i brezeve me vlerë të posaçme ekonomike për shërbimet IMT, përkatsisht përcaktimin e pragut të çmimit për pagesat e njëhershme të këtyre resurseve frekuenore si dhe rekomadimin lidhur me mënyrat e dhënjes.</p> <p>Në përmbushje të objektivave për zhvillimin e rrjeteve mobile brezgjera, ARKEP është i përkushtuar dhe i angazhuar që tërë procesi për hapjen dhe dhënjen e brezeve të jetë në përputhje me parimet rregullimit të aktiviteteve të komunikimeve elektronike siç janë: përdorimi efektiv i resurseve të kufizuara frekuenore, sigurimi i konkurrencës efektive,</p>

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e Telekomit të Kosovës sh.a.	Përgjigja e ARKEP
			kushteve dhe procedurave rregullatore, transparencës dhe mosdiskriminimit.
1	<p>Cilat nga brezet frekuencore për shërbimet IMT konsideroni se duhet të hapen, jepni arsyetimin dhe listoni sipas prioritetit?</p> <p>a) 800 MHz b) 900 MHz c) 1800 MHz d) 2100 MHz e) 2600 MHz, dhe f) 3400-3800 MHz.</p>	<p>Hapja dhe dhënia e brezeve konsiderohet jo vetëm si nevojë për shkak të rritjes së trafikut të të dhënave, por duhet konsideruar edhe ndikimin e tyre të drejtpërdrejt në nivelin ekonomik të vendit (GDP). Për sa u përket përfitimeve të drejtpërdrejta të konsumatorit nga përdorimi i këture brezeve, elementi kryesor është zhvillimi i "Internet of Things -IoT- që po zhvillohet gradualisht në nivel global. Siç dihet, shërbimet dhe aplikacionet e ndryshme të rasteve të përdoruesve të IoT janë klasifikuar në katër kategoritë e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. IoT Public (aplikacione që i shërbejnë publikut të gjerë); 2. IoT Industry (aplikacione që ndihmojnë në përmirësimin e efikasitetit të përgjithshëm të ndërmarrjes dhe atë industrial); 3. IoT Appliance (shtëpi inteligjente); 4. IoT Personal. <p>Megjithëse mundësia që ofron IoT konsiderohet nga industria e komunikimeve elektronike si e rëndësishme dhe multidimensionale në terma afatgjatë (5-10 vitet e ardhshëm), rastet e biznesit aktual nuk janë akoma plotësisht të qarta dhe kërkojnë investim paraprak në infrastrukturë. Trendi në ulje i të ardhurave dhe fitimeve në sektorin e komunikimeve elektronike ndikon në konkurrencën afatgjatë dhe kapacitetin e operatorëve në sektorin e investimeve (përfshirë këtu licencat e reja për përdorimin e spektrit), karakterizuar nga zhvillimet e teknologjisë dinamike dhe investimet e</p>	<p>ARKEP vlereson se procesi i dhënies së brezeve frekuencore për shërbimet IMT mund të bëhet në tri faza:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Faza e parë: Ripërtrirja e autorizimeve aktuale për operatorët Telekomit i Kosovës dhe IPKO lidhur me resurset frekuencore ekzistuese në shfrytëzim në kuadër të brezeve 900 MHz dhe 1800 MHz, sipas mënyrës së drejtpërdrejtë, duke marrë si bazë çmimin "One-Off" të përcaktuar nga ARKEP për dhënien e këtyre kapaciteteve. 2. Faza e dytë: Hapja e brezeve, të cilat nuk janë në shfrytëzim, përfshirë edhe kapacitetet frekuencore në disponim nga operatori me autorizim të përkohshëm mts D.O.O., do t'i nënshtrohet procedurave të tenderit ose ankandit, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Komunikimet Elektronike. Në këtë fazë do të përfshihen brezet frekuencore 800 MHz, 900 MHz, 1800

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e Telekomit të Kosovës sh.a.	Përgjigja e ARKEP
		<p>nivelit të lartë, ndërkohë që është fakt që të ardhurat që sigurohen nga shërbimet janë të ulëta dhe nuk arrijnë të justifikojnë investimet e nevojshme.</p> <p>Duke konsideruar gjithashtu edhe faktin se politikat e qeverisë kanë për qëllim përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimeve me brez të gjerë, TK apelon dhe kërkon mbështetje edhe nga qeveria, që duke patur parasysh zhvillimin dhe avancimet teknologjike, të shtyjë me prioritet projekte për të mbështetur industrinë si: bujqësia, kujdesi shëndetësor, prodhimin, energjitikën si dhe shërbimet e tjera, gjë që i shërben objektivit të investimeve të reja në teknologjitë inovative dhe përmirëson cilësinë e shërbimeve të ofruara ndaj konsumatorëve, si dhe do të ndihmonte shumë operatorët në të bërit biznes dhe në zgjerimin e mëtejme të gamës së shërbimeve.</p> <p>Të gjitha brezet e listuara në procesin e këshillimit publik duhet të hapen. Renditja dhe arsyet njëkohësisht sipas prioriteteve janë si me poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Brezet aktualisht të përdorura nga TK, 900 MHz dhe 1800 MHz, janë të nevojshme për vazhdimin e funksionimit të rrjetit në teknologjitë ekzistuese GSM, UMTS dhe LTE si dhe pajisjet ekzistuese radio punojnë në këto breze. 2. Brezi 2100 për rritje të kapacitetit të 3G sidomos në vende të dendura urbane. 3. Brezi 800 MHz me qëllim shfrytëzimin e saj për LTE dhe mbulimin me LTE në vendet rurale dhe rritjen e nivelit në ambientet e brendshme. 	<p>MHz, 2100 MHz dhe 2600 MHz.</p> <p>3. Faza e tretë: Përfshinë dhënien e kapaciteteve të pa alokuara frekuencore për shërbimet IMT në kuadër të brezeve 700 MHz, 3400-3800 MHz dhe 26 GHz.</p> <p>Lidhur me zhvillimin e shërbimeve IoT, ARKEP do të zbatoj rekomandimet më të reja evropiane të CEPT/ECC, të cilat përcaktojnë mënyrën e shfrytëzimit të këtyre shërbimeve.</p> <p>Aktualisht, ARKEP i ka përfshirë këto shërbime në planifikimin e përdorimit të brezeve 900 MHz dhe 1800 MHz.</p>

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e Telekomit të Kosovës sh.a.	Përgjigja e ARKEP
		4. 2600 MHz dhe 3400-3800 MHz për qellim shfrytëzimin në gjeneratën e ardhshme 5G.	
2	Kur mendoni se është koha më e përshtatshme për iniciimin e procedurës për dhënien në shfrytëzim të këtyre brezeve?	<p>Së pari, marrë parasysh faktin se autorizimet individuale të TK për shfrytëzimin e brezeve frekuencore për shërbimet GSM/IMT do të skadojnë vitin e ardhshëm, TK e ka të domosdoshme garantimin e operimit, ofrimit të shërbimeve të duhura e të përshtatshme në territorin e Republikës së Kosovës dhe mbrojtjen e investimeve të deritashme. Atëherë, në përputhje me ligjin, si dhe duke marr parasysh se resurset janë të bollshme që të përmbushin nevojat e operatorëve, TK konsideron që autorizimet aktuale në brezet 900MHz dhe 1800MHz, të vazhdohen dhe të jepen në mënyrë të drejtpërdrejt. Për më tepër, edhe sa i përket hapjes së brezeve të tjera dhe kërkesave të ardhshme për brez shtesë, njëjtë, konsiderojmë që duhet të vazhdohet me dhënie të drejtpërdrejt.</p> <p>Pra, brezet 900 MHz dhe 1800 MHz janë të shfrytëzueshme deri me date 30.07.2019. Para kësaj date, për brezet 900 MHz dhe 1800 MHz, duhet të iniciohet procedura për dhënien në shfrytëzim së bashku me brezin 2100 MHz dhe 800 MHz, por edhe brezet tjera. Për TK është e rëndësishme që, në momentin kur është i nevojshëm brezi i caktuar, të ketë të drejtë shfrytëzimin e tij nga data e kërkuar nga TK. Prandaj, TK mendon që çdo brez të jetë në dispozicion të TK në gjerësi të caktuar frekuencore të rezervuar dhe të garantuar për TK nga ARKEP. Me fjale të tjera, ndarja e spektrit frekuencorë për brez të caktuar të jetë</p>	<p>Afatet për iniciimin e procedurës për dhënien resurseve frekuencore do të jetë si në vijim:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Faza e parë: për dhënien e kapaciteteve frekuencore në brezet 900 MHz dhe 1800 MHz, të cilat aktualisht janë në shfrytëzim nga operatorët Telekomit i Kosovës dhe IPKO, ARKEP do të nxjerr vendim të veçantë në gjysmën e parë të vitit 2019, para skadimit të vlefshmërisë së tyre. 2. Faza e dytë: Përfshinë dhënien e kapaciteteve frekuencore në brezet tjera që nuk janë në shfrytëzim, përfshirë edhe kapacitetet frekuencore në disponim nga operatori me autorizim të përkohshëm mts D.O.O., do t'i nënshtrohet procedurave të tenderit ose ankandit, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Komunikimet Elektronike. Në këtë fazë do të përfshihen brezet frekuencore 800 MHz, 900 MHz, 1800 MHz, 2100 MHz dhe 2600 MHz. Kjo fazë do të inicohet në gjashtë mujorin e

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e Telekomit të Kosovës sh.a.	Përgjigja e ARKEP
		proporcionale.	<p>dytë të vitit 2019.</p> <p>3. Faza e tretë: Përfshinë dhënien e kapaciteteve të pa alokuara frekuencore për shërbimet IMT në kuadër të brezeve: 700 MHz, 3400-3800 MHz dhe 26 GHz. Kjo fazë do të iniciohet pas vitit 2022.</p> <p>Varësisht nga kërkesa dhe nevoja për zhvillimin e tregut, ARKEP mund të iniciojë procedurën për dhënien e kapaciteteve frekuencore në këto breze dhe breze të tjera në përputhje me trendet e zhvillimit të shërbimeve IMT, rekomandimet evropiane dhe dispozitat ligjore.</p>
3	Cili është kapaciteti frekuencorë që e konsideroni të nevojshëm në kuadër të secilit brez frekuencorë, i cili është me interes për zhvillimin e mëtutjeshëm të rrjeteve mobile brezgjëra?	Shih komentet në shkresën e operatorit	Duke pas parasyshë faktin se kërkesat e operatorëve në shumicën e brezeve i tejkalojnë kapacitetet e planifikuara, atëherë në përputhje me nevojën për zhvillimin e mëtutjeshëm të shërbimeve mobile brezgjëra, ARKEP do të vlerësojë mundësinë e vendosjes së kufizimeve lidhur me kapacitet frekuencore që mund t'i këtë në dispozicion/apo mund t'i fitojë të drejtën e shfrytëzimit një operator.

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e Telekomit të Kosovës sh.a.	Përgjigja e ARKEP
4	<p>Cilën nga mënyrat e dhënies në shfrytëzim të brezeve frekuencore (Ankand, Tender, ndarje e drejtpërdrejtë) e konsideroni si më të përshtatshme dhe jepni arsyetimin?</p>	<p>TK konsideron që dhënia në shfrytëzim e brezeve frekuencore të jetë me ndarje të drejtpërdrejt. Kjo mënyrë garanton vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve aktuale dhe lehtësira në zhvillim të teknologjive në të ardhmen.</p> <p>Mënyra e dhënies në shfrytëzim të brezeve frekuencore me anë të ankadit apo tenderit në kushtet dhe tregun në Republikën e Kosovës, TK konsideron se nuk është i përshtatshëm dhe atë duke pasur për bazë vështirësitë, kompleksitetin dhe përvojat e shteteve të BE-së dhe të vendeve regionale. Shembull, ankandet tani pranohen përgjithësisht si një "praktikë e mirë" për caktimin e spektrit kur kërkesa tejkalon disponueshmërinë, mirëpo, kur spektri është i mjaftueshëm, mënyra administrative e dhënies së të drejtës është e pranueshme. Në përgjithësi TK është e bindur që ankandet e BE-së nuk mund të krahasohen me situatën në Kosovë. Ankandet tipike në BE ofrojnë shumë spektër për operatorët, me gjithë faktin se këta operatorë vetëm se kanë shumë spektër të mjaftueshëm në disponueshmëri. Për shembull, ankandi gjerman i vitit 2015 ofroi 270 MHz dhe pas ankandit secili prej tre operatorëve kishte më shumë se 200 MHz spektër, duke e përdorur atë kryesisht për LTE Advanced me shumë agregim të bartësve.</p> <p>Përkundër që mënyra e ankandit dhe tenderit janë praktikuar në shumë vende, këto mënyra megjithë atributet e mira si në aspektin e efikasitetit dhe të gjenerimit të të ardhurave, kanë disavantazhet e veta dhe kritikohen ndër të tjera edhe në disa baza:</p>	<p>Siç kemi theksuar me lartë, ARKEP vlereson se ripërtrirja e autorizimeve aktuale për operatorët Telekomit i Kosovës dhe IPKO lidhur me resurset frekuencore ekzistuese në shfrytëzim në kuadër të brezeve 900 MHz dhe 1800 MHz, mund të bëhet sipas mënyrës së drejtpërdrejtë, duke marrë si bazë çmimin minimal për dhënien e këtyre kapaciteteve</p> <p>Sa i përket brezeve tjera, do t'i nënshtrohen procedurave të tenderit ose ankandit, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Komunikimet Elektronike.</p> <p>Lidhur me hyrjen operatorit të tretë, ARKEP do të merr në konsideratë praktikën me të mira ndërkombetare dhe obligimet nga Marrëveshja e Telekomunikacionit.</p> <p>Poashtu ARKEP do të merr në konsideratë edhe rekomandimet e kompanisë konsulente për vlerësimin e brezeve dhe mënyrën e dhënies së resurseve frekuencore.</p>

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e Telekomit të Kosovës sh.a.	Përgjigja e ARKEP
		<ol style="list-style-type: none"> 1. Operatorët paguajnë "shumë" në ankand; 2. Tarifat e larta të licencës do të thotë çmime më të larta për konsumatorët; 3. Pagesat e mëdha të licencës dëmtojnë financat e operatorëve, duke i shtyer ato të hyjnë në borxhe; 4. Nëse operatorët shpenzojnë shuma të mëdha për të marrë një licencë, ata do të investojnë më pak në infrastrukturë; 5. Ankandet vënë theksin vetëm në çmimet dhe nuk marrin parasysh objektivat e tjera që Politikat Zhvillimore të Qeverisë kanë synim t'i ndjekin; <p>Njejtë, duhet marrë parasysh, se për shkak të shumave të mëdha të parave që përfshihen në këtë proces, rregullat e pjesëmarrjes në një ankand të brezit duhet të jenë të qarta në mënyrë të maksimalizimit të besimit në proces, duke inkurajuar pjesëmarrjen dhe për të shmangur proceset gjyqësore si rezultat të një padie për një lojë të padrejtë nga një pjesëmarrës. Për më tepër, ankandet janë mjaft të shtrenjta për t'u organizuar dhe drejtuar dhe shumica e ankandëve tani u ipen në udhëheqje këshilltarëve të jashtëm të cilët ndihmojnë në hartimin e ankandit për të arritur qëllimet strategjike të qeverisë si dhe ekzekutimin e ankandit. Gjithashtu, kërkohen angazhime të konsiderueshme nga ana e operatorit (p.sh. njohja me rregullat e ankandit, trajnimi, punësimi i ekspertëve të ankandit dhe avokatëve, e posaqerisht duhet vënë në vëmendje se TK është ndërmarrje publike dhe është jo e barabartë në proces të kontraktimit të këtyre lloj shërbimeve, përshtatja e</p>	

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e Telekomit të Kosovës sh.a.	Përgjigja e ARKEP
		<p>planeve të biznesit në varësi të ofertave të mundshme etj.). Siç u tha, kjo mënyrë e caktimit do të jetë barrë e madhe për të gjithë, ku të gjitha këto shpenzime do të mund të investoheshin në përmirësimin dhe modernizimin e tregut të komunikimeve elektronike.</p> <p>Gjithashtu, mënyra e dhënies së resurseve nëpërmjet tenderit, ka disavantazhet e veta. Në një procedurë tenderuese, zakonisht komisionet përcaktojnë një numër të kriterëve dhe specifikave të ndryshme dhe obligative. Më pas, ofertat e kandidatëve vlerësohen nga një komision që për zgjedh dosjen që ka "kombinimin/ofertën" më të mirë të këtyre kriterëve. Në rastin e alokimit të spektrit për shërbimet mobile, kriteret e përcaktuara paraprakisht mund të përfshijnë kriteret e përgjithshme të tilla si biznes planin, sigurinë financiare, besueshmërinë dhe investimet në të ardhmen, si dhe kriteret më specifike, si shtrirja dhe shpejtësia e rrjetit, kërkesa për mbulimin gjeografik dhe/ose të popullsisë, çmimi, kualiteti i shërbimeve, dhe konkurueshmëria. Pra, çështje e rëndësishme në tender, janë hartimi i kriterëve, shkalla/fleksibiliteti në të cilën kriteret mund të jenë të zëvendësueshme dhe pastaj se si do të vlerësohen/maten kriteret përkatëse, ku me këtë nënkuptohet se vendimmarrja është subjektive dhe gjithëmonë lë vend për zvarritje dhe ankesa të ndryshme.</p> <p>Është e rëndësishme të theksohet se dallimi midis ankandit dhe tenderit nuk është aq i dukshëm sa mund të duket në shikim të parë. Edhe ankandet mund të kërkojnë që pjesëmarrësit të plotësojnë një sërë</p>	

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e Telekomit të Kosovës sh.a.	Përgjigja e ARKEP
		<p>parametrash teknike për operim dhe ofrim të shërbimeve. Dallimi kryesor midis dy metodave të alokimit del nga theksi që i ipet mekanizmit të çmimeve. Në një ankand, oferta konkurruese e çmimit është vendimtare, ndërsa në një tender nuk është.</p> <p>Atëherë, TK kërkon që të garantohet si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Në çdo kohë të garantohet sasia e mjaftueshme për secilin nga dy operatorët në tregun tonë, duke marr parasysh se ka spektër të bollshëm në dispozicion edhe nëse në të ardhmen hapet tregu për ndonjë operatorë të tretë, duke siguruar kështu mjedisin e duhur të konkurrencës së drejtë dhe të ndershme për të zhvilluar produktet dhe shërbimet e tyre mbi këtë breze, duke konkurruar në kushte të barabarta; 2. Propozon ndjekjen e praktikave dhe përvojave më të mira dhe parimet udhëzuese të BE, mirëpo, gjithmonë duke pasur parasysh që “one size does not fit all” ku nuk ka një metodë të vetme apo të ngjashme që mund të supozohet të jetë e zbatueshme për të gjitha vendet, pa rrezikun e uljes të përfitimit të përgjithshëm të konsumatorit dhe vlerës ekonomike. Si pikënisje, kur përcaktohen objektivat për dhënien e brezeve frkekuencore, duhet të merren parasysh: <ul style="list-style-type: none"> -Struktura e Tregut në Kosovë, konkurrencës, zhvillimet e tregut dhe teknologjisë duke 	

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e Telekomit të Kosovës sh.a.	Përgjigja e ARKEP
		<p>përfshirë koston e investimeve; depërtimi i smartfonëve; kërkesa e konsumatorit; mbulimi ekzistues; cilat teknologji mund të priten me arsye që të përdorin spektrin në të ardhmen e parashikueshme, etj. Mbi këto baza, TK përsëritë që procesi i alokimit duhet të implementohet si një procedurë e dhënies në mënyrë të drejtpërdrejt.</p> <p>3. TK konsideron se që nga hyrja në treg e operatorit të dytë të telefonisë mobile, ky treg i kësaj industrie që nga ajo kohë është mjaft konkurrues, sidomos duke patur parasysh faktin se ekzistojnë edhe dy operatorë virtual.</p> <p>Bazuar në përvojat e kaluara mund të konkludohet se mënyra e ndarjes së brezeve nuk ka qenë e njëjtë dhe e barabartë për të dy operatorët, (TK viti 2004, IPKO viti 2007), si nga shuma e paguar ashtu edhe kapacitetit të dhënë në shfrytëzim. Përderisa TK në total deri në vitin 2012 ka patur në përdorim vetëm 2x13.6 MHz në brezin 900 MHz, në vitin 2007, IPKO i janë dhënë 2x10 MHz në brezin 900 Mhz dhe 2x10 MHz në brezin 1800 MHz. Ndërsa, në kontekst të trajtimit të barabartë nga ana e institucioneve të Republikës së Kosovës në bashkëpunim me ARKEP, merret parasysh fakti, se para hyrjes në treg të operatorit të dytë të telefonisë mobile, TK përveç pagesave të taksave të rregullta si korporatë, duke mos përfshirë dividendën, nga viti 2005 deri në vitin 2007, Telekomit i Kosovës ka realizuar pagesë në vlerë</p>	

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e Telekomit të Kosovës sh.a.	Përgjigja e ARKEP
		<p>prej 62 mil Euro, në emër të taksës si operues i vetëm i telefonisë mobile në tregun e Kosovës. Andaj, për të siguruar mosdiskriminimin dhe barazinë në trajtimin e ofruesve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, konkurrencën efektive; madhësinë e tregut në Republikën e Kosovës, si dhe në rekomandimin e Agjensionit Kosovar të Konkurrencës, me të cilën konstaton se: tregu i telefonisë mobile tashmë është konkurrues, atëherë, TK kërkon nga ARKEP, që të mos fillojnë procedurat e tenderit/ankandit për përzgjedhjen e operatorit të tretë të telefonisë mobile, të paktën përderisa tregu i kësaj industrie nuk bie ndesh me parimet dhe kriteret e konkurrencës së drejtë dhe efektive. Më tej, TK rekomandon, që në të ardhmen, në rast të përcaktimit dhe vendimit eventual të ARKEP për të filluar përgatitjen e hapjes së procedurave për përzgjedhjen e operatorit të tretë të telefonisë mobile në emër të konkurrencës, atëherë, rekomandojmë që operatorët aktual të mos kenë të drejtë të marrin pjesë në procesin e ndarjes së frekuencave.</p>	
5	<p>A e konsideroni si qasje të duhur hapjen e të gjitha brezeve frekuencore të disponueshme?</p>	<p>TK e konsideron shumë të rëndësishme dhe të domosdoshme hapjen e të gjitha brezeve frekuencore të disponueshme për sistemet telekomunikuese mobile ashtu që të ofrohen shërbime mobile brezgjëra me cilësi të larta në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.</p>	<p>Duke pasur parasysh objektivat për zhvillimin e mëtutjeshëm të shërbimeve mobile brezgjëra, plotësimin e nevojave të tregut, si dhe menaxhimin efikas dhe efektiv të resurseve frekuencore, ARKEP synon hapjen e të gjitha brezeve sipas fazave dhe afateve të specifikuara</p>

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e Telekomit të Kosovës sh.a.	Përgjigja e ARKEP
			më lartë (shih më gjerësishtë përgjigjen 2 dhe 3).
6	Sa e konsideroni të nevojshëm dhe me interes shfrytëzimin e Teknologjive TDD për shërbime UMTS në të gjitha brezet, por në veçanti në blloqet e pa çiftuara frekuencore 1900–1920 MHz ose 2010–2025 MHz të brezit 2.1 GHz.	Duke u bazuar në trendet e zhvillimit në rajon dhe Evropë, aktualisht TK nuk sheh një interes të zhvillimit të teknologjive të bazuara në TDD.	ARKEP do të merr parasysh komentet e operatorëve në planifikimin e ardhshëm të këtij brezi bazuar në rekomandimet evropiane të CEPT/ECC për radio komunikime.
7	Cilat nga brezet frekuencore i konsideroni se duhet të hapen në bllok/paketë?	Për TK është e rëndësishme që në bllok/paketë të hapen brezet 800/900/1800/2100 si dhe blloku 2600/3400-3800 në fazë më të vonshme për zgjerim të kapaciteteve dhe zhvillim të gjeneratës së 5G.	Varësisht nga mënyra e dhënies së resurseve frekuencore (tender ose ankand), nevoja për zgjerimin e shërbimeve brezgjëra në tërë territorin e Republikës së Kosovës, nxitjen e investimeve, sigurimi i kualitetit më të mirë të shërbimeve për konsumatorët, si dhe rritjen mëtutjeshme të konkurrencës efektive në tregun e komunikimeve elektronike, ARKEP do t'a shqyrtoj edhe mundësinë e dhënies në bllok/paketë të brezeve të caktuara frekuencore.
8	Për cilat breze e konsideroni të nevojshme vendosjen e obligimeve për mbulueshmëri?	Sipas praktikave të deritashme kryesisht vendosja e obligimeve për mbulueshmëri bëhet vetëm për brezet nën 1GHz të njohura si brezet frekuencore për mbulim.	Në përputhje me praktikat me të mira ndërkombetare, objektivat për zhvillimin dhe shtrirjen e shërbimeve mobile brezgjëra, nxitjen e investimeve në sektor, ARKEP do të shqyrtoj mundësinë e vendosjes së obligimeve për

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e Telekomit të Kosovës sh.a.	Përgjigja e ARKEP
			mbulueshmeri. Në veçanti, ARKEP do të shqyrtoj mundësinë e vendosjes së obligimeve për brezet nën 1GHz.
9	A mendoni se duhet të vendosen obligime për mbulueshmërinë indoor krahas asaj outdoor?	TK mendon që vendosja e obligimeve për mbulueshmëri indoor nuk është e përshtatshme.	Në përgjithësi, bazuar në praktikën e vendeve evropiane, vendosja e obligimeve indoor nuk aplikohet në shkallë të gjërë. Por, në rast të nevojave për mbulimin e zonave/hapsirave të caktuara me interes më të gjërë për konsumatorët, ARKEP mund të konsideroj si të nevojshme vendosjen e obligimeve për mbulueshmëri indoor.
10	A e konsideroni të nevojshme vendosjen e kërkesave specifike për mbulueshmëri në viset rurale?	TK konsideron të nevojshme vendosjen e kërkesave specifike për mbulueshmëri në viset rurale vetëm për brezet nën 1GHz.	Shih përgjigjen numër 8.
11	Cili është sugjerimi i juaj lidhur me autorizimet për të drejtën e shfrytëzimit të brezeve frekuencore për shërbimet IMT, validiteti i të cilave pritet të skadojë brenda viteve 2019-2022?	Për brezet që priten të skadojnë brenda viteve 2019-2022, autorizimi për të drejtën e shfrytëzimit të brezeve frekuencore sugjerohet që të rinovohet. Duke marr parasysh se operatorët përgjatë operimit kanë plotësuar standardet në kuptimin e përdorimit të spektrit për objektivat dhe qëllimet e synuara, atëherë, në përputhje me rregullat dhe politikën, do të duhej që të njëjtit të mund të paraqesin kërkesat për rinovim. Është e pakuptimtë që e drejta e shfrytëzimit të mos vazhdohet, duke marr parasysh që spektri është i domosdoshëm për	Në përputhje me praktikën e vendeve ndërkombetare për dhënie të resurseve frekuencore në brezet e dedikuara për shërbimet IMT, ARKEP synon që të jep të drejtën e shfrytëzimit të kapaciteteve frekuencore për periudha afatgjate prej 10 deri 20 vite. Mirëpo, periudha e preferuar nga ARKEP për dhënie të kapaciteteve frekuencore

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e Telekomit të Kosovës sh.a.	Përgjigja e ARKEP
		<p>operim.</p> <p>Është e rëndësishme në këtë rast të shqyrtohet edhe kohëzgjatja e vlefshmërisë së Autorizimit. Autorizimet individuale (prej 15 vjetësh) janë në zbatim të Ligjit të Komunikimeve Elektronike. Megjithatë, TK bën një referencë ndaj pjesës së resurseve në Rishikimin në proces të Rregullores Europiane të Telekomunikimeve. Ajo bazohet në propozimin fillestar të Komisionit European (KE) për një kohëzgjatje minimale të licensës prej 25 vitesh, si benchmark për rregulloret e ardhshme për spektrin në Europë. Shkurt mes KE-së, Parlamentit European dhe Këshillit të Ministrave Europiane, u ra dakort për një kohëzgjatje minimale të harmonizuar prej 20 vitesh (ose ku nuk ushtrohej në një hap të vetëm, më pak se 20 vjet plus një zgjatje kohe përkatëse) (shiko më poshtë nenin 49 formulimin për Kodin European të Komunikimeve elektronike EECC). Kjo merr në konsideratë investime të mëdha në infrastrukturë të cilat nevojiten për të mbuluar vendin me teknologji moderne mobile me brez të gjerë dhe u lejon konsumatorëve fundor dhe nga biznesi në gjithë vendin të përfitojnë qasje të shpejtë në internet nga aparatet mobile. Prandaj, ARKEP duhet të eksplorojë të gjitha mundësitë për zgjatjen e periudhës së parashikuar të licensës nga 15 vjet në 20 vjet ose të shtojë një zgjatje të garantuar prej 5 vjetësh pas përfundimit të periudhës së parë, si pjesë e kushteve të licensës.</p> <p>Në rast se ARKEP parashikon një periudhë 15-vjeçare në kushtet e licensës së ardhshme për brezet, TK është e mendimit që ARKEP të shtojë një kohëzgjatje shtesë si pjesë e kushteve të licensave të ardhshme, siç është</p>	<p>është 15 vite.</p> <p>ARKEP gjatë procesit të ripërteritjes së autorizimeve individuale për radio frekuenca që kanë në shfrytëzim operatorët Telekomit i Kosovës dhe IPKO, do të analizoj praktikat më të mira për harmonizimin e afateve kohore për të drejtën e shfrytëzimit të tyre.</p>

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e Telekomit të Kosovës sh.a.	Përgjigja e ARKEP
		<p>parashikuar në formulimin e Nenit 49, pika 2 e draftit të Kodit Europian të Komunikimeve Elektronike EECC, si më poshtë:</p> <p>Article 49 © Duration of rights © Where Member States © authorise the use of radio spectrum through individual © grant rights of use for a limited period of time, © they shall ensure that the authorisation is granted for a period that is © the duration shall be appropriate for the service concerned in view of the objective pursued taking due account of the need to © ensure effective and efficient use and promote efficient investments, including © allow © by allowing © for an appropriate period for investment amortisation.</p> <p>2. Where Member States grant rights of use for harmonised radio spectrum for a limited period of time, those rights of use for harmonised radio spectrum shall be valid for a duration of at least 25 years, except in the case of temporary rights, temporary extension of rights pursuant to paragraph 3 and rights for secondary use in harmonised bands.</p> <p>3. Member States may extend the duration of rights of use for a short period of time to ensure the simultaneous expiry of rights in one or several bands.</p> <p>Në fund, Telekomit i Kosovës i propozon dhe i apelon ARKEP, që brezet duhet të jenë të disponueshme me një çmim të volitshëm dhe në vend të realizimit të pagesës</p>	

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e Telekomit të Kosovës sh.a.	Përgjigja e ARKEP
		on-off të mundësojë pagesat me këste, gjegjësisht, në këtë procedurë të bëjë aplikimin e pagesave vjetore përgjatë afatit të plotë të licensave si alternativë. Propozimi ynë bazohet duke pasur parasysh një varg faktorësh që kanë të bëjnë me gjendjen e tregut të komunikimeve elektronike në Republikën e Kosovës, trendin aktual të të hyrave të operatorëve si dhe gjendjen e përgjithshme finaciare. Është mendim i përgjithshëm se tarifat vjetore do të japin stimul më të mirë për përdorim efikas sesa pagesat fillestare.	
12	A e konsideroni si të domosdoshme vendosjen e kufizimeve lidhur me blloqet frekuencore që mund t'i ketë në dispozicion/fitoj të drejtën e shfrytëzimit një operator?	Parimisht TK e mbështetë idenë e vendosjes së kufizimeve lidhur me blloqet frekuencore për të shmangur ndonjë situatë monopolizimi. Poashtu, TK konsideron që ndarja dhe sasia e brezeve të jetë sipas kërkesave të operatorëve dhe në harmoni me pikën 3 dhe gjithmonë duke pasur parasysh parimin e proporcionalitetit dhe jo diskriminimit.	Me qëllim të krijimit të kushteve të barabarta për të gjithë operatorët dhe menaxhimit efikas dhe efektiv, ARKEP e konsideron si të nevojshme vendosjen e kufizimeve lidhur me blloqet frekuencore që mund t'i ketë në dispozicion/fitoj të drejtën e shfrytëzimit një operator.
13	Komente tjera shtesë	//	//

SHTOJCA II
Përgjigjet e ARKEP ndaj komenteve të operatorit IPKO

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e operatorit IPKO	Përgjigja e ARKEP
/	Koment i përgjithshëm	<p>Duhet të theksohet se me spektrin frekuencor ekzistues të ndarë, është e pamundur që Qeveria e Kosovës të përmbushë këtë objektivë. Kjo e fundit, nëpërmjet ARKEP-it, duhet të sigurojë që brezi 800MHz të ndahet sa më shpejtë që të jetë e mundur, në kushte shumë të favorshme për operatorët, pasi që vetëm me një gamë të spektrit të frekuencave të larta dhe të ulëta, operatorët do të ishin në gjendje të siguronin mbulueshmëri të qëndrueshme të shërbimeve të zërit dhe internetit mobil në zonat urbane dhe rurale.</p> <p>Ndërsa pajtohem se ndarja shtesë është thelbësore për arritjen e objektivit të lartpërmendur, megjithatë nuk pajtohem që penetrimi i internetit prej 87.80% është penetrim i ultë.</p> <p>IPKO konsideron se përderisa ARKEP duhet patjetër të udhëhiqet nga shembulli i BE-së, megjithatë në dokumentin e saj duhej të kishte pranuar se Kosova e ka lëshuar mundësinë për të zhvilluar shërbimet brez-gjera mobile, duke qenë se ARKEP është vonuar shumë në liberalizimin e frekuencave dhe ndarjen e atyre shtesë për operatorët ekzistues. Për këtë arsye, në Kosovë shumë aktivitete të tjera të tilla si ndarja e spektrit, zhvillimi i 4G, harmonizimi i frekuencave ekzistuese etj.,</p>	<p>Në përmbushje të objektivave për zhvillimin e rrjeteve mobile brezgjera, ARKEP është i përkushtuar dhe i angazhuar që tërë procesi për hapjen dhe dhënen e brezeve të jetë në përputhje me parimet rregullimit të aktiviteteve të komunikimeve elektronike siç janë: përdorimi efektiv i resurseve të kufizuara frekuencore, sigurimi i konkurrencës efektive, kushteve dhe procedurave rregullatore, transparencës dhe mosdiskriminimit.</p> <p>Sa i përket indikatorëve të tregut, përketesisht penetrimi i shërbimeve mobile brezgjera, këto të dhënat janë të bazuara nga raportet periodike të operatorëve.</p>

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e operatorit IPKO	Përgjigja e ARKEP
		<p>duhet të kryhen përpara se të fillojnë diskutimet për zbatimin e 5G që në mënyrë efektive, do të thotë që ofrimi i shërbimit 5G në Kosovë mund të ndodhin rreth vitit 2023- 2024, sepse Kosova duhet të përqendrohet në zhvillimin e brezit të gjerë mobil 4G deri në atë kohë.</p> <p>Dhe, përfundimisht, paraqitja e shtrirjes/penetrimit i shërbimeve mobile brez-gjëra në figurën 2 të dokumentit tuaj është plotësisht joreale.</p> <p>Siç shihet nga të dhënat e paraqitura nga ne, penetrimi i shërbimeve brez-gjera mobile, respektivisht në teknologjitë UMTS dhe LTE, në vitin 2017 ka qenë 57%, dukshëm më i ultë se përqindja e paraqitur nga ARKEP (85%).</p>	
1	<p>Cilat nga brezet frekuencore për shërbimet IMT konsideroni se duhet të hapen, jepni arsyetimin dhe listoni sipas prioritetit?</p> <p>a) 800 MHz b) 900 MHz c) 1800 MHz d) 2100 MHz e) 2600 MHz, dhe f) 3400-3800 MHz.</p>	<p>Para se të hapet çfarëdo brezi i ri, është qëndrim i IPKO's që ARKEP së pari duhet të harmonizojë përdorimin e frekuencave të IPKO dhe Telekomit të Kosovës. IPKO do të kërkojë dhe duhet të marrë 5MHz shtesë në brezin 1800MHz, duke pasur parasysh faktin se ka paguar në mënyrë të konsiderueshme më shume se Telekomit të Kosovës për brezin frekuencor, në mënyrë që të ketë spektrin e njëjtë si konkurrenca. Për të siguruar këtë, meqë IPKO nuk ka njohuri për planet e Telekomit të Kosovës, ARKEP duhet të mbaj takime me operatorët, edhe të përbashkëta nëse ka nevojë.</p>	<p>ARKEP vlereson se procesi i dhënies së brezeve frekuencore për shërbimet IMT mund të bëhet në tri faza:</p> <p>1. Faza e parë: Ripërtirja e autorizimeve aktuale për operatorët Telekomit të Kosovës dhe IPKO lidhur me resurset frekuencore ekzistuese në shfrytëzim në kuadër të brezeve 900 MHz dhe 1800 MHz, sipas mënyrës së drejtpërdrejtë,</p>

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e operatorit IPKO	Përgjigja e ARKEP
		<p>Pas këtij hapi, kohëzgjatja e licencave duhet të harmonizohet për brezat aktualë (dhe brezat shtesë 5Mhz në 1800MHz për IPKO) që operatorët i kanë në përdorim, pasi që frekuencat e TK-së skadojnë në vitin 2019, ndërsa ato të IPKO's në vitin 2022 (duke përjashtuar një pjesë të brezit 1800MHz që gjithashtu skadon në vitin 2019).</p> <p>ARKEP më pas duhet të zgjasë validitetin e vlefshmërisë së brezave në përdorim nga dy operatorë për 15-25 vjet të tjera. IPKO konsideron që zgjatja e tillë do të ishte me praktike të bëhet në vitin 2019, në mënyrë që operatorët të jenë plotësisht të harmonizuar në përdorim të frekuencave. Natyrisht që një zgjatje e tillë e vlefshmërisë duhet të bëhet me çmime të bazuar në çmime të aplikuara nga vendet evropiane (benchmark) të cilat duhet t'i përshtatet kushteve ekonomike të vendit.</p> <p>Dhe pas kësaj, të gjithë brezat duhet të hapen, sipas radhës së prioritetit që vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> i. 800 MHz ii. 1800 MHz iii. 2100 MHz iv. 2600 MHz, v. 900 MHz 	<p>duke marrë si bazë çmimin "One-Off" të përcaktuar nga ARKEP për dhënien e këtyre kapaciteteve.</p> <p>2. Faza e dytë: Hapja e brezeve, të cilat nuk janë në shfrytëzim, përfshirë edhe kapacitetet frekuencore në disponim nga operatori me autorizim të përkohshëm mts D.O.O., do t'i nënshtrohet procedurave të tenderit ose ankandit, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Komunikimet Elektronike. Në këtë fazë do të përfshihen brezet frekuencore 800 MHz, 900 MHz, 1800 MHz, 2100 MHz dhe 2600 MHz.</p> <p>3. Faza e tretë: Përfshinë dhënien e kapaciteteve të pa alokuara frekuencore për shërbimet IMT në kuadër të brezeve: 700 MHz, 3400-3800 MHz dhe 26 GHz.</p> <p>Lidhur me zhvillimin e shërbimeve IoT, ARKEP do të zbatoj rekomandimet më të reja evropiane të CEPT/ECC, të cilat përcaktojnë mënyrën e shfrytëzimit të këtyre shërbimeve.</p>

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e operatorit IPKO	Përgjigja e ARKEP
		vi. 700 Mhz vii. 3400-3800 MHz	<p>Aktualisht, ARKEP i ka përfshirë këto shërbime në planifikimin e përdorimit të brezeve 900 MHz dhe 1800 MHz.</p> <p>ARKEP gjatë procesit të ripërteritjes së autorizimeve individuale për radio frekuenca që kanë në shfrytëzim operatorët Telekom i Kosovës dhe IPKO, do të analizoj praktikat më të mira për harmonizimin e afateve kohore për të drejtën e shfrytëzimit të tyre.</p>
2	<p>Kur mendoni se është koha më e përshtatshme për iniciimin e procedurës për dhënien në shfrytëzim të këtyre brezeve?</p>	<p>Siç u theksua më lart, bazuar në kushtet e tregut të krijuar nga ARKEP deri më tani (me vendim shumë të vonuar për liberalizimin e frekuencave për shërbimet 3G dhe çmime jashtëzakonisht të larta për brezat 1800 MHz dhe 2100 MHz), zgjidhja e vetme për operatorët është zgjerimi i brezave ekzistues që ata i kanë në përdorim. Kjo duhet të iniciohet në vitin 2018, duke marrë parasysh skadimin e licencave ekzistuese për Telekomin e Kosovës, si dhe për IPKO-n për 2x10 MHz në brezin 1800 MHz.</p> <p>Në vitin e njëjtë, 2018, ARKEP duhet gjithashtu të iniciojë procesin e ndarjes së drejtpërdrejtë të frekuencave të reja në brezin 800MHz. ARKEP duhet të</p>	<p>Afatet për iniciimin e procedurës për dhënien resurseve frekuencore do të jetë si në vijim:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Faza e parë: për dhënien e kapaciteteve frekuencore në brezet 900 MHz dhe 1800 MHz, të cilat aktualisht janë në shfrytëzim nga operatorët Telekom i Kosovës dhe IPKO, ARKEP do të nxjerr vendim të veçantë në gjysmën e parë të vitit 2019, para skadimit të vlefshmërisë së tyre. 2. Faza e dytë: Përfshinë dhënien e kapaciteteve frekuencore në brezet tjera që nuk janë në shfrytëzim, përfshirë

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e operatorit IPKO	Përgjigja e ARKEP
		<p>marrë në konsideratë faktin se i gjithë procesi i ndarjes dhe caktimit zgjat disa muaj, si edhe fillimi i përdorimit më pas, gjithashtu.</p> <p>Ndërkaq, pas ndarjes së drejtpërdrejtë të brezit 800 MHz, ne konsiderojmë se procesi për ndarjen e 2100, 2600 MHz, 700 MHz dhe 3500-3700 MHz duhet të fillojë në vitin 2021, kurse brezat e tjerë më të lartë të tillë si 24Ghz, 31Ghz, mund të ndahen edhe më vonë. Megjithatë, është thelbësore që ARKEP të bëjë një parashikim 5-10 vjet për kërkesën e ardhshme të spektrit komercial për Kosovën, në mënyrë që të sigurojë kushte të parashikueshme të tregut për lojtarët e tregut.</p>	<p>edhe kapacitetet frekuencore në disponim nga operatori me autorizim të përkohshëm mts D.O.O., do t'i nënshtrohet procedurave të tenderit ose ankandit, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Komunikimet Elektronike. Në këtë fazë do të përfshihen brezet frekuencore 800 MHz, 900 MHz, 1800 MHz, 2100 MHz dhe 2600 MHz. Kjo fazë do të inicohet në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2019.</p> <p>3. Faza e tretë: Përfshinë dhënien e kapaciteteve të pa alokuara frekuencore për shërbimet IMT në kuadër të brezeve: 700 MHz, 3400-3800 MHz dhe 26 GHz. Kjo fazë do të iniciohet pas vitit 2022.</p> <p>Varësisht nga kërkesa dhe nevoja për zhvillimin e tregut, ARKEP mund të iniciojë procedurën për dhënien e kapaciteteve frekuencore në këto breze dhe breze të tjera në përputhje me trendet e zhvillimit të shërbimeve IMT, rekomandimet evropiane dhe dispozitat ligjore.</p>

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e operatorit IPKO	Përgjigja e ARKEP
			<p>Brezi 700 MHz aktualisht është i alokuar për shërbime radiodifuzive.</p> <p>Prandaj, duke u mbështetur në rekomandimet evropiane, ARKEP do të angazhohet që lirimi i këtij brezi nga shërbimet radiodifuzive dhe alokimi për shërbimet IMT të bëhet sa më shpejt, ashtu që procesi i dhënies së këtyre resurseve frekuencore të ndodh pas vitit 2022.</p> <p>Sa i përket brezeve tjera, në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tregut, ARKEP do të shqyrtoj dhe planifikoj shfrytëzimin e tyre për shërbimet IMT.</p>
3	Cili është kapaciteti frekuencorë që e konsideroni të nevojshëm në kuadër të secilit brez frekuencorë, i cili është me interes për zhvillimin e mëtutjeshëm të rrjeteve mobile brezgjëra?	Shih komentet në shkresën e operatorit	Duke pas parasyshë faktin se kërkesat e operatorëve në shumicën e brezeve i tejkalojnë kapacitetet e planifikuara, atëherë në përputhje me nevojën për zhvillimin e mëtutjeshëm të shërbimeve mobile brezgjëra, ARKEP do të vleresojë mundësinë e vendosjes së kufizimeve lidhur me kapacitet frekuencore që mund t'i këtë në dispozicion/apo mund t'i fitojë të drejtën e shfrytëzimit një operator.
4	Cilën nga mënyrat e dhënies në shfrytëzim të	Për spektrin ekzistues, ARKEP duhet vetëm të miratojë një vendim për zgjatjen e të njëjtit, me një çmim normal.	Siç kemi theksuar me lartë, ARKEP vlereson se ripërtrirja e autorizimeve aktuale për operatorët

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e operatorit IPKO	Përgjigja e ARKEP
	<p>brezeve frekuencore (Ankand, Tender, ndarje e drejtpërdrejtë) e konsideroni si më të përshtatshme dhe jepni arsyetimin?</p>	<p>Kjo praktikë tashmë është përdorur nga autoritetet rregullatore në rajon (Mali i Zi). Në rast se operatorët do të blejnë frekuenca shtesë në 900 MHz dhe 1800 MHz, kjo duhet të bëhet me ndarjen e drejtpërdrejtë.</p> <p>Ndarja e drejtpërdrejtë e frekuencave gjithashtu duhet të përdoret për alokimin e spektrit në brezin 800MHz. Konsiderojmë se kjo është metoda më e përshtatshme, për shkak të arsyeve të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ekziston spektër i mjaftueshëm për të dy operatorët ne brezin 800MHz, madje edhe për një të tretin potencial në të ardhmen e largët, prandaj operatorëve eksistues duhet t’ju ndahet së paku 2x10Mhz në këtë brez, me mundësinë e ndarjes edhe të 2x15Mhz (për operatorin e tretë në një të ardhme të largët brezi më i ulët 700Mhz mund të përdoret) - Para se të hapet mundësia për një operator të ri në treg, ARKEP duhet të bëjë harmonizimin e frekuencave ekzistuese për periudhën pas vitit 2022. Kjo do të thotë që asnjë operator i ri nuk duhet të hyjë para vitit 2022, sic është shpjeguar në pikën vijuese); - ARKEP duhet të pamundësoj hyrjen e operatorit të ri në këtë moment. Operatorët ekzistues tashmë janë dëmtuar mjaftueshëm me: <ul style="list-style-type: none"> o zhvillimin e vonshëm të shërbimeve brezgjera mobile, duke i obliguar ata që të kompensojnë përdoruesit me WiFi (ende 	<p>Telekomi i Kosovës dhe IPKO lidhur me resurset frekuencore ekzistuese në shfrytëzim në kuadër të brezeve 900 MHz dhe 1800 MHz, mund të bëhet sipas mënyrës së drejtpërdrejtë, duke marrë si bazë çmimin minimal për dhënien e këtyre kapaciteteve.</p> <p>Sa i përket brezeve tjera, do t’i nënshtrohen procedurave të tenderit ose ankandit, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Komunikimet Elektronike.</p> <p>Lidhur me hyrjen operatorit të tretë, ARKEP do të merr në konsideratë praktikatat me të mira ndërkombetare dhe obligimet nga Marrëveshja e Telekomunikacionit.</p> <p>Poashtu ARKEP do të merr në konsideratë edhe rekomandimet e kompanisë konsulente për vlerësimin e brezeve dhe mënyrën e dhënies së resurseve frekuencore.</p>

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e operatorit IPKO	Përgjigja e ARKEP
		<p>rreth 75% të përdoruesve të telefonave mobil i qasen WiFi),</p> <ul style="list-style-type: none"> o përdorimi i lartë i aplikacioneve për komunikim, siç janë Viber, ËhatsApp, e Skype kanë pasur sukses të lartë tek përdoruesit kosovar, dhe 90% nga këta të fundit kanë deklaruar se e përdorin Viber, duke zvogëluar kështu konsumimin e shërbimeve të zërit. Nga 2012, trafiku total i origjinuar ka rënë për rreth 40% si rezultat i përdorimit të këtyre aplikacioneve, ndërsa trafiku ndërkombëtar ka rënë për më shumë se 80%. Të gjitha këto më lartë kanë ndikuar në rënie prej 50% të ARPU nga vitit 2012-2017, dhe rënie totale të të hyrave, me çka operatorët po përballen me pasoja edhe sot. Prandaj, atyre u duhet dhënë mundësia që të zhvillohen para se një hyrësit të ri t'i ipet mundësia të hyj në treg; - IPKO tashmë ka paguar çmime të larta për ndarjen e spektrit, dhe është diskriminuar dhe dëmtuar kryesisht në krahasim me Telekomin e Kosovës. Tabela e mëposhtme tregon ndryshimin e pagesës për ndarjen e frekuencave nga IPKO dhe Telekomin i Kosovës. <p>Prandaj, bazuar në më sipër, është e qartë se ndarja e drejtpërdrejtë është metoda e vetme e përshtatshme e</p>	

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e operatorit IPKO	Përgjigja e ARKEP
		<p>ndarjes së brezit 800MHz në këtë moment. ARKEP gjithashtu duhet të jetë i kujdesshëm që kushtet financiare për ndarjen e drejtpërdrejtë të këtij spektri duhet të përputhet me pritjet e tregut, në mënyrë që më në fund të zbusë dëmet e bëra operatorëve për shkak të nisjes së vonuar të shërbimeve 3G.</p>	
5	<p>A e konsideroni si qasje të duhur hapjen e të gjitha brezeve frekuencore të disponueshme?</p>	<p>Në këtë fazë, konsiderohet se fokusi duhet të vendoset në zgjatjen e licencave për brezat e përdorur aktualisht dhe shtimin e spektrit të nevojshëm 800/1800 për zhvillim të 4G sipas përgjigjeve të mësipërme.</p> <p>Publikimi i planit për hapjen e të gjithë brezave mund të jetë e arsyeshme pasi që operatorët do të kenë nevojë gjithnjë e më shumë spektër për të siguruar ofrimin e shërbimeve të ardhshme (IoT, shërbime me bazë 5G ...) por vetëm nëse sigurohet çmimi i favorshëm jo vetëm për ndarje të frekuencave por edhe për çmimet vjetore për përdorimin e tyre. Komunikimi i planit për hapjen e të gjithë brezave frekuencor me çmime të favorshme do të siguronte të dyja parashikueshmërinë e investimeve dhe përpjekjeve si dhe përqendrimin në investimet në zgjerimin e rrjetit që do të ngrit jo vetëm nivelin e cilësisë së shërbimeve të telekomunikacionit, por do të shërbejë si bazë për përmirësimin e përgjithshëm të ekonomisë së Kosovës.</p>	<p>Duke pasur parasysh objektivat për zhvillimin e mëtutjeshëm të shërbimeve mobile brezgjera, plotësimin e nevojave të tregut, si dhe menaxhimin efikas dhe efektiv të resurseve frekuencore, ARKEP synon hapjen e të gjitha brezeve sipas fazave dhe afateve të specifikuara më lartë (shih më gjerësishtë përgjigjen 2 dhe 3).</p>

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e operatorit IPKO	Përgjigja e ARKEP
		Meqenëse sipas tabelës së mësipërme koha për përdorimin e brezave shtesë (p.sh. 700 MHz, 2600 MHz) është pas disa vitesh, kjo duhet të merret parasysh edhe kur të përcaktohen kushtet.	
6	Sa e konsideroni të nevojshëm dhe me interes shfrytëzimin e Teknologjive TDD për shërbime UMTS në të gjitha brezet, por në veçanti në blloqet e pa çiftuara frekuencore 1900–1920 MHz ose 2010–2025 MHz të brezit 2.1 GHz.	Nuk është me interes për IPKO-n, ngjashëm me shënimin tuaj në dokumentin tuaj: <i>“Shumë shtete të BE-së gjithashtu kanë dhënë spektrin e pa çiftuar (TDD) në brezin 2 GHz (1900–1920 MHz ose 2010–2025 MHz), megjithatë tani interesimi i operatorëve në Evropë për këtë brez është më i vogël”</i>	ARKEP do të merr parasyshë komentet e operatorëve në planifikimin e ardhshëm të këtij brezi bazuar në rekomandimet evropiane të CEPT/ECC për radio komunikime.
7	Cilat nga brezet frekuencore i konsideroni se duhet të hapen në bllok/paketë?	Blloqet në vijim mund të hapen në blloqe: - 800/1800Mhz, - 2100/2600Mhz, dhe - 700/3500-3700Mhz.	Varësisht nga mënyra e dhënies së resurseve frekuencore (tender ose ankand), nevoja për zgjerimin e shërbimeve brezgjëra në tërë territorin e Republikës së Kosovës, nxitjen e investimeve, sigurimi i kualitetit më të mirë të shërbimeve për konsumatorët, si dhe rritjen mëtutjeshme të konkurrencës efektive në tregun e komunikimeve elektronike, ARKEP do t’a shqyrtoj edhe mundësinë e dhënies në bllok/paketë të brezeve të caktuara frekuencore.
8	Për cilat breze e	Asnjë. Obligimet e mbulimit që nuk janë të nevojshme	Në përputhje me praktikat me të mira

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e operatorit IPKO	Përgjigja e ARKEP
	<p>konsideroni të nevojshme vendosjen e obligimeve për mbulueshmëri?</p>	<p>dhe vetëm se do të ngarkonin operatorin. Siç u përcaktua më lart, operatorëve duhet t'u sigurohen kushte të drejta të çmimit për blerjen e frekuencave, në mënyrë që ata të stimulohen për të investuar sa më shumë që të jetë e mundur. ARKEP është mjaft i vetëdijshëm për situatën e vështirë financiare të operatorëve mobil në Kosovë, prandaj kjo duhet të merret parasysh.</p> <p>Përveç kësaj, është në interesin e operatorëve që të depërtojnë sa më shumë që të jetë e mundur me shërbimet e tyre, prandaj për aq sa u lihet hapësirë për investime duke mos i ngarkuar operatorët me çmime të larta të frekuencave, këta të fundit do të investojnë në mbulim me qëllim që të arrijnë më shumë konsumatorë.</p> <p>Përveç kësaj, ARKEP tashmë është i vetëdijshëm për vështirësitë me të cilat IPKO po përballlet me komunat vetëm për marrjen e lejes mjedisore nga ata për vendosjen e antenave në territorin e tyre, pasi që ata i bëjnë lloj-lloj kërkesash IPKO-s të cilat madje as nuk parashihen me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2017 për Lejet Komunale të Mjedisit (si p.sh. pëlqimi nga Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen nga Rrezatimi për rrezatim jo-jonizues, pëlqimi nga qytetarët që jetojnë në atë zonë dhe ngjashëm). Prandaj, i tërë procesi i vendosjes së një lokacioni të vetëm të GSM-së mund të zgjasë disa muaj. Prandaj, çdo lloj detyrimi për</p>	<p>ndërkombetare, objektivat për zhvillimin dhe shtrirjen e shërbimeve mobile brezgjëra, nxitjen e investimeve në sektor, ARKEP do të shqyrtoj mundësinë e vendosjes së obligimeve për mbulueshmëri.</p> <p>Në veçanti, ARKEP do të shqyrtoj mundësinë e vendosjes së obligimeve për brezet nën 1GHz.</p>

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e operatorit IPKO	Përgjigja e ARKEP
		mbulueshmëri do të duhet të ndiqet edhe nga ndryshimet në legjislacionin e Kosovës për emetimet e rrezatimit si dhe ndryshimet në procedurat për sigurimin e vendndodhjeve të lokacionit në mënyrë që të sigurohet që do të jetë e mundur të rritet dendësia e rrjetit.	
9	A mendoni se duhet vendosen obligime për mbulueshmërinë indoor krahas asaj outdoor?	Jo. Ju lutem shihni përgjigjen tonë në pyetjen e 8-të.	Në përgjithësi, bazuar në praktikat e vendeve evropiane, vendosja e obligimeve indoor nuk aplikohet në shkallë të gjërë. Por, në rast të nevojave për mbulimin e zonave/hapsirave të caktuara me interes më të gjërë për konsumatorët, ARKEP mund të konsideroj si të nevojshme vendosjen e obligimeve për mbulueshmëri indoor.
10	A e konsideroni të nevojshme vendosjen e kërkesave specifike për mbulueshmëri në viset rurale?	Jo nga perspektiva e operatorit. Ju lutem shihni dy përgjigjet e mëparshme.	Shih përgjigjen numer 8.
11	Cili është sugjerimi i juaj lidhur me autorizimet për të drejtën e shfrytëzimit të brezeve frekuencore për shërbimet IMT, validiteti i	Siç u tha më lart, ARKEP së pari duhet të harmonizojë përdorimin e frekuencave, që do të thotë se duhet të sigurojë që të dy operatorët përdorin të njëjtat frekuenca, si dhe të harmonizojnë validitetin e përdorimit të frekuencave, që do të thotë që zgjatja e	Në përputhje me praktikat e vendeve ndërkombetare për dhënien e resurseve frekuencore në brezet e dedikuara për shërbimet IMT, ARKEP synon që të jep të drejtën e shfrytëzimit të kapaciteteve

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e operatorit IPKO	Përgjigja e ARKEP
	<p>të cilave pritet të skadojë brenda viteve 2019-2022?</p>	<p>periudhës për të dy operatorët duhet të bëhet për periudhën e njëjtë, duke filluar nga viti 2019.</p> <p>Licencave eksistuese në përdorim në bendet 900MHz dhe 1800MHz të përdorura nga operatorët duhet t'u vazhdohet validiteti në vitin 2019. Mungesa e harmonizimit të afatit të tyre mund të shkaktoj disa problem: përderisa frekuencat e përdorura nga Telekom i Kosovës skadojnë në 2019, ato të IPKO's, shumica skadojnë në 2022, ndërsa një pjesë e 1800Mhz skadon në 2019.</p> <p>Në këtë kontest, një zgjidhje e mundshme do të ishte thjeshtëzimi i këtyre afateve duke I harmonizuar të gjitha në vitin 2019. Sipas një skenari të tillë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Autorizimi i Telekomit të Kosovës skadon dhe do të vazhdohej më 2019; - Frekuencat e IPKO's që skadojnë në 2022 do të mund të harmonizoheshin në 2019 (i.e. duke përcaktuar një validitet për IPKO që është 3 vite më i shkurtër) në shkëmbim të zbritjes për çmimin e frekuencave që IPKO tashmë e ka paguar deri në vitin 2022. Një zbritje e tillë mund të përdoret si zbritje për pagesën që do të bëhej për zgjatjen e validitetit të frekuencave aktuale, apo për ndarjen/blerjen e frekuencave të reja. <p>Pas zhvillimeve të fundit në Evropë, validiteti i</p>	<p>frekuencore për periudha afatgjate prej 10 deri 20 vite. Mirëpo, periudha e preferuar nga ARKEP për dhënien e kapaciteteve frekuencore është 15 vite.</p> <p>ARKEP gjatë procesit të ripërteritjes së autorizimeve individuale për radio frekuenca që kanë në shfrytëzim operatorët Telekom i Kosovës dhe IPKO, do të analizoj praktikat më të mira për harmonizimin e afateve kohore për të drejtën e shfrytëzimit të tyre.</p>

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e operatorit IPKO	Përgjigja e ARKEP
		<p>autorizimit duhet të jetë në kohëzgjatje prej 25 vjetësh, por në asnjë rast nuk duhet të jetë më e shkurtër se 15 vjet për të siguruar besueshmërinë e biznesit dhe investimet adekuate në rrjet.</p>	
12	<p>A e konsideroni si të domosdoshme vendosjen e kufizimeve lidhur me blloqet frekuencore që mund t'i ketë në dispozicion/fitoj të drejtën e shfrytëzimit një operator?</p>	<p>Ju lutem sqarojeni pyetjen.</p>	<p>Me qëllim të krijimit të kushteve të barabarta për të gjithë operatorët dhe menaxhimit efikas dhe efektiv, ARKEP e konsideron si të nevojshme vendosjen e kufizimeve lidhur me blloqet frekuencore që mund t'i ketë në dispozicion/fitoj të drejtën e shfrytëzimit një operator.</p>
13	<p>Komente tjera shtesë</p>	<p>Në 7 vitet e fundit përdorimi i zërit dhe të ardhurat kanë rënë në mënyrë domethënëse dhe nuk ishte e mundur të mbulohen këto të hyra të humbura nëpërmjet rritjes së trafikut të të dhënave. Për të qenë në gjendje t'i stabilizojnë operatorët dhe të sigurojnë zhvillimin e ardhshëm të shërbimeve të telekomunikacionit në Kosovë, kushte më të favorshme, dhe në veçanti kushte financiare, duhet të ofrohen në caktimet e ardhshme të spektrit.</p> <p>Siç është treguar më lart, në të kaluarën IPKO ka paguar tarifa shumë më të larta krahasuar me konkurrentin, i cili në mënyrë efektive e vë IPKO në pozitë më të vështirë për investime të mëtejshme dhe është diskriminuese nga perspektiva e tregut. Andaj, në të</p>	<p>Shih përgjigjet më lartë.</p>

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e operatorit IPKO	Përgjigja e ARKEP
		<p>ardhmen çdo lloj i dhënies së frekuencës duhet të sigurojë kushte të barabarta për të gjithë operatorët në mënyrë që të ruhet konkurrenca e tregut.</p> <p>Përveç kësaj, IPKO pret, ngjashëm si në shumë vende Evropiane, se rregullatori së shpejti do të përgatisë strategji transparente dhe strategji të frekuencave publike që paraqet hapat e planifikuara për caktimin e spektrit në 5-10 vitet e ardhshme. Kjo është me rëndësi vendimtare për parashikueshmërinë e biznesit, planifikimin adekuat të investimeve dhe zhvillimin e biznesit të telekomunikacionit në Kosovë.</p>	

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e operatorit Dardafon.net	Përgjigja e ARKEP
/	Koment i përgjithshëm	<p>Dardafon.net LLC (Z Mobile) është duke operuar në tregun e komunikimeve elektronike, përkatësisht ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile për rreth 13 vite në Republikën e Kosovës në cilësinë e operatorit virtual të rrejtit. Përgjatë operimit tonë në treg si operator virtual i rrejtit ne kemi kontribuar maksimalisht në ofrimin e shërbimeve konkurrencte dhe me cmime të pranueshme për qytetarët dhe klientët tanë. Ne poashtu kemi krijuar një bazë shumë të mirë të profesionistëve brenda stafit të Z-Mobile të cilët e shohin të mundshëm zgjerimin e mëturjeshëm të biznesit tonë në ofrimin direkt të shërbimeve të rrejtit të telefonisë mobile. Në lidhje me këtë mundësi ne kemi kontakte dhe bashkëpunim me disa nga operatorët më të mëdhenjë botëror të cilët janë në gjendje ta mbështesin kompaninë tonë në rast të ndërtimit të rrejtit të qasjes së telefonisë mobile. Duke pasur parasysh se në Republiken e Kosovës për dallim nga të gjitha vendet e rajonit kemi vetëm dy operator të rrejtit të telefonisë mobile, konsiderojmë që ka hapsirë komerciale për zhvillim të mëturjeshëm të këtij tregu duke lejuar edhe operimin e më shumë operatorëve. Sigurisht, se kompania jonë është e interesuar që të vazhdojë të jetë aktive në këtë treg dhe duke pasur një bazë të mirë të klientëve dhe përvojë në fushë, është mirë e pozicionuar për ta zhvilluar më tutje këtë treg, por hyrja ose jo do të varet nga kushtet që ofrohen nga shteti për zhvillim të mëturjeshëm të sektorit, treg i cili sic dihet tanimë ka</p>	<p>Në përmbushje të objektivave për zhvillimin e rrjeteve mobile brezgjera, ARKEP është i përkushtuar dhe i angazhuar që tërë procesi për hapjen dhe dhënjen e brezeve të jetë në përputhje me parimet rregullimit të aktiviteteve të komunikimeve elektronike siç janë: përdorimi efektiv i resurseve të kufizuara frekuencore, sigurimi i konkurrencës efektive, kushteve dhe procedurave rregullatore, transparencës dhe mosdiskriminimit.</p>

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e operatorit Dardafon.net	Përgjigja e ARKEP
		<p>pasur një rënie në të hyra që nga viti 2010 e tutje. Prandaj, ne përfundimisht jemi të interesuar të aplikojmë për breze frekuencore dhe shpresojmë që standardet që do të përdoren për këtë mundësi të jenë në pajtueshmëri me ato evropiane si dhe cmimet të jenë të përballueshme për këtë treg që ka pasur rënie që një kohë të gjatë.</p>	
1	<p>Cilat nga brezet frekuencore për shërbimet IMT konsideroni se duhet të hapen, jepni arsyetimin dhe listoni sipas prioritetit?</p> <p>a) 800 MHz b) 900 MHz c) 1800 MHz d) 2100 MHz e) 2600 MHz, dhe f) 3400-3800 MHz.</p>	<p>Ne mendojmë që duhet të hapen brezi, 900 MHz, 800MHz dhe 1800MHz fillimisht, ndërsa pastaj brezet 2100MHz, 2600MHz dhe 3400-3800 MHz.</p>	<p>ARKEP vlereson se procesi i dhënies së brezeve frekuencore për shërbimet IMT mund të bëhet në tri faza:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Faza e parë: Ripërtirja e autorizimeve aktuale për operatorët Telekom i Kosovës dhe IPKO lidhur me resurset frekuencore ekzistuese në shfrytëzim në kuadër të brezeve 900 MHz dhe 1800 MHz, sipas mënyrës së drejtpërdrejtë, duke marrë si bazë çmimin "One-Off" të përcaktuar nga ARKEP për dhënien e këtyre kapaciteteve. 2. Faza e dytë: Hapja e brezeve, të cilat nuk janë në shfrytëzim, përfshirë edhe kapacitetet frekuencore në disponim nga operatori me autorizim të përkohshëm mts D.O.O., do t'i

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e operatorit Dardafon.net	Përgjigja e ARKEP
			<p>nënshtrohet procedurave të tenderit ose ankandit, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Komunikimet Elektronike. Në këtë fazë do të përfshihen brezet frekuencore 800 MHz, 900 MHz, 1800 MHz, 2100 MHz dhe 2600 MHz.</p> <p>3. Faza e tretë: Përfshinë dhënien e kapaciteteve të pa alokuara frekuencore për shërbimet IMT në kuadër të brezeve: 700MHz, 3400-3800 MHz dhe 26 GHz.</p>
2	Kur mendoni se është koha më e përshtatshme për iniciimin e procedurës për dhënien në shfrytëzim të këtyre brezeve?	Ne mendojmë që sa më shpejt që procedohet me këtë proces është aq më mirë, por afati optimal duhet të jetë fillimi i vitit 2019.	<p>Afatet për iniciimin e procedurës për dhënien resurseve frekuencore do të jetë si në vijim:</p> <p>1. Faza e parë: për dhënien e kapaciteteve frekuencore në brezet 900 MHz dhe 1800 MHz, të cilat aktualisht janë në shfrytëzim nga operatorët Telekom i Kosovës dhe IPKO, ARKEP do të nxjerr vendim të veçantë në gjysmën e parë të vitit 2019, para skadimit të vlefshmërisë së tyre.</p>

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e operatorit Dardafon.net	Përgjigja e ARKEP
			<p>2. Faza e dytë: Përfshinë dhënien e kapaciteteve frekuencore në brezet tjera që nuk janë në shfrytëzim, përfshirë edhe kapacitetet frekuencore në disponim nga operatori me autorizim të përkohshëm mts D.O.O., do t'i nënshtrohet procedurave të tenderit ose ankandit, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Komunikimet Elektronike. Në këtë fazë do të përfshihen brezet frekuencore 800 MHz, 900 MHz, 1800 MHz, 2100 MHz dhe 2600 MHz. Kjo fazë do të inicohet në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2019.</p> <p>3. Faza e tretë: Përfshinë dhënien e kapaciteteve të pa alokuara frekuencore për shërbimet IMT në kuadër të brezeve: 700MHz, 3400-3800 MHz dhe 26 GHz. Kjo fazë do të iniciohet pas vitit 2022.</p> <p>Varësisht nga kërkesa dhe nevoja për zhvillimin e tregut, ARKEP mund të iniciojë procedurën për dhënien e kapaciteteve frekuencore në këto breze dhe breze të tjera në përputhje me</p>

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e operatorit Dardafon.net	Përgjigja e ARKEP
			trendet e zhvillimit te sherbimeve IMT, rekomandimet evropiane dhe me dispozitat ligjore.
3	Cili është kapaciteti frekuencorë që e konsideroni të nevojshëm në kuadër të secilit brez frekuencorë, i cili është me interes për zhvillimin e mëtutjeshëm të rrjeteve mobile brezgjëra?	Shih komentet në shkresën e operatorit	Duke pas parasyshë faktin se kërkesat e operatorëve në shumicën e brezeve i tejkalojnë kapacitet e planifikuara, atëherë në përputhje me nevojën për zhvillimin e mëtutjeshëm të shërbimeve mobile brezgjëra, ARKEP do të vleresojë mundësinë e vendosjes së kufizimeve lidhur me kapacitet frekuencore që mund t'i këtë në dispozicion/apo mund t'i fitojë të drejtën e shfrytëzimit një operator.
4	Cilën nga mënyrat e dhënies në shfrytëzim të brezeve frekuencore (Ankand, Tender, ndarje e drejtpërdrejtë) e konsideroni si më të përshtatshme dhe jepni arsyetimin?	Ne mendojmë që secila formë është e përshtatshme, edhe pse ne do të preferonim ankandin, por në cdo rast kjo procedurë duhet të zhvillohen në mënyrë transparente dhe në përputhje me standardet ndërkombtare.	Siç kemi theksuar me lartë, ARKEP vlereson se ripërrirja e autorizimeve aktuale për operatorët Telekomit i Kosovës dhe IPKO lidhur me resurset frekuencore ekzistuese në shfrytëzim në kuadër të brezeve 900 MHz dhe 1800 MHz, mund të bëhet sipas mënyrës së drejtpërdrejtë, duke marrë si bazë çmimin minimal për dhënien e këtyre kapaciteteve. Sa i përket brezeve tjera, do t'i nënshtrohen procedurave të tenderit ose ankandit, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Komunikimet Elektronike.

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e operatorit Dardafon.net	Përgjigja e ARKEP
			<p>Lidhur me hyrjen operatorit te tretë, ARKEP do të merr në konsideratë praktikat me të mira ndërkombetare dhe obligimet nga Marrëveshja e Telekomunikacionit.</p> <p>Poashtu ARKEP do të merr në konsideratë edhe rekomandimet e kompanisë konsulente për vleresimin e brezeve dhe mënyrën e dhënies së resurseve frekuencore.</p>
5	A e konsideroni si qasje të duhur hapjen e të gjitha brezeve frekuencore të disponueshme?	Qasja është e duhur, por një gjë e tillë duhet të mundësohet për të gjithë te interesuarit e posacërisht kompanitë me përvojë në treg.	Duke pasur parasysh objektivat për zhvillimin e mëtutjeshëm të shërbimeve mobile brezgjera, plotësimin e nevojave të tregut, si dhe menaxhimin efikas dhe efektiv të resurseve frekuencore, ARKEP synon hapjen e të gjitha brezeve sipas fazave dhe afateve të specifikuar më lartë (shih më gjerësisht përgjigjen 2 dhe 3).
6	Sa e konsideroni të nevojshëm dhe me interes shfrytëzimin e Teknologjive TDD për shërbime UMTS në të gjitha brezet, por në veçanti në blloqet e pa çiftuara frekuencore 1900–1920 MHz ose 2010–2025 MHz të brezit 2.1 GHz.	E shohim të nevojshme por jo prioritet sepse ekzistojnë edhe mundësi dhe zjidhje tjera teknike.	ARKEP do të merr parasyshë komentet e operatorëve në planifikimin e ardhshëm të këtij brezi bazuar në rekomandimet evropiane të CEPT/ECC për radio komunikime.
7	Cilat nga brezet	900 dhe 1800 MHz, 800 dhe 2100MHz pastaj tjerat.	Varësisht nga mënyra e dhënies së resurseve

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e operatorit Dardafon.net	Përgjigja e ARKEP
	frekuencore i konsideroni se duhet të hapen në bllok/paketë?		frekuencore (tender ose ankand), nevoja për zgjerimin e shërbimeve brezgjëra në tërë territorin e Republikës së Kosovës, nxitjen e investimeve, sigurimi i kualitetit më të mirë të shërbimeve për konsumatorët, si dhe rritjen mëtutjeshme të konkurrencës efektive në tregun e komunikimeve elektronike, ARKEP do t'a shqyrtoj edhe mundësinë e dhënies në bllok/paketë të brezeve të caktuara frekuencore.
8	Për cilat breze e konsideroni të nevojshme vendosjen e obligimeve për mbulueshmëri?	Ne nuk e shohim të dosmosdoshme vendosjen e këtyre obligimeve, sepse është në iteresin tonë të ketë mbulueshmëri të plotë në të gjithë vendin në cdo rast.	Në përputhje me praktikat me të mira ndërkombetare, objektivat për zhvillimin dhe shtrirjen e shërbimeve mobile brezgjëra, nxitjen e investimeve në sektor, ARKEP do të shqyrtoj mundësinë e vendosjes së obligimeve për mbulueshmeri. Në veçanti, ARKEP do të shqyrtoj mundësinë e vendosjes së obligimeve për brezet nën 1GHz
9	A mendoni se duhet vendosen obligime për mbulueshmërinë indoor krahas asaj outdoor?	Mendojmë që mbulueshmëria në indoor është vështirë e matshme por edhe se konkurrenca më e madhe do të shtyente në përmirësim të vazhdueshëm të kualitetit indoor dhe outdoor, prandaj është e nevojshme të ketë më shumë se dy operator të rrjetit.	Në përgjithësi, bazuar në praktikat e vendeve evropiane, vendosja e obligimeve indoor nuk aplikohet në shkallë të gjërë. Por, në rast të nevojave për mbulimin e zonave/hapsirave të caktuara me interes më të gjërë për konsumatorët, ARKEP mund të konsideroj si të nevojshme vendosjen e

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e operatorit Dardafon.net	Përgjigja e ARKEP
			obligimeve për mbulueshmëri indoor.
10	A e konsideroni të nevojshme vendosjen e kërkesave specifike për mbulueshmëri në viset rurale?	Kjo duhet të jetë e lidhur me mundësinë e ndarjes së brezit 800MHz si edhe me qasjen shtetërore ndaj investimeve në viset rurale sidomos në broadband.	Shih përgjigjen numër 8.
11	Cili është sugjerimi i juaj lidhur me autorizimet për të drejtën e shfrytëzimit të brezeve frekuencore për shërbimet IMT, validiteti i të cilave pritet të skadojë brenda viteve 2019-2022?	Mendojmë që duhet të kemi një qasje transparente dhe jo diskriminuese dhe në rast se vendoset që këto autorizime të vazhdohen ato duhet të bartin edhe obligimet me vete.	<p>Në përputhje me praktikat e vendeve ndërkombetare për dhënien e resurseve frekuencore në brezet e dedikuara për shërbimet IMT, ARKEP synon që të jep të drejtën e shfrytëzimit të kapaciteteve frekuencore për periudha afatgjate prej 10 deri 20 vite. Mirëpo, periudha e preferuar nga ARKEP për dhënien e kapaciteteve frekuencore është 15 vite.</p> <p>ARKEP gjatë procesit të ripërteritjes së autorizimeve individuale për radio frekuenca që kanë në shfrytëzim operatorët Telekom i Kosovës dhe IPKO, do të analizoj praktikat më të mira për harmonizimin e afateve kohore për të drejtën e shfrytëzimit të tyre.</p>
12	A e konsideroni si të	Po, është e domosdoshme të ketë kufizime dhe maksimume në mënyrë që të ketë shfrytëzim adekuat të	Me qëllim të krijimit të kushteve të barabarta

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e operatorit Dardafon.net	Përgjigja e ARKEP
	domosdoshme vendosjen e kufizimeve lidhur me blloqet frekuencore që mund t'i ketë në dispozicion/fitoj të drejtën e shfrytëzimit një operator?	brezeve.	për të gjithë operatorët dhe menaxhimin efikas dhe efektiv, ARKEP e konsideron si të nevojshme vendosjen e kufizimeve lidhur me blloqet frekuencore që mund t'i ketë në dispozicion/fitoj të drejtën e shfrytëzimit një operator.
13	Komente tjera shtesë	Ne konsiderojmë se në rast të tenderit apo ankadit duhet të merret parasysh ekspertiza e kompanive aplikante si dhe të mundësohet në cdo rast qasje jo diskriminuese e operatorëve të ri në krahasim me ata aktual, një gjë e tillë do ta rriste ofertën në treg dhe do të kishte efekt pozitiv në zhvillimin e vendit. Sic dihet shumë mirë, komunikimet e lira dhe kualitative elektronike janë parakusht për zhvillim ekonomik të vendeve, kjo vlenë edhe më shumë për Kosovën si një shtet me një moshë mesatare shumë të re dhe potencial për zhvillim të mëtutjeshëm të sektorit të teknologjisë dhe informacionit.	Lidhur me hyrjen operatorit të tretë, ARKEP do të merr në konsideratë praktikën me të mira ndërkombetare dhe obligimet nga Marrëveshja e Telekomunikacionit. Poashtu ARKEP do të merr në konsideratë edhe rekomandimet e kompanisë konsulente për vlerësimin e brezeve dhe mënyrën e dhënies së resurseve frekuencore.

SHTOJCA IV
Përgjigjet e ARKEP ndaj komenteve të operatorit 'mts' D.O.O.

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e operatorit mts D.O.O.	Përgjigja e ARKEP
/	Koment i përgjithshëm	//	//
1	<p>Cilat nga brezet frekuencore për shërbimet IMT konsideroni se duhet të hapen, jepni arsyetimin dhe listoni sipas prioritetit?</p> <p>a) 800 MHz b) 900 MHz c) 1800 MHz d) 2100 MHz e) 2600 MHz, dhe f) 3400-3800 MHz.</p>	<p>Konsiderojmë që duhet hapur brezat: 800MHz, 900MHz, 1800MHz dhe 2100MHz (prioriteti i parë), 2600MHz (prioriteti i dytë), 3400-3800MHz (prioriteti i tretë). Brezat 900/1800/2100MHz janë breza që tani e disa vite i përdorin numri më i madh i operatorëve në Evropë dhe paraqesin bazën e shumicës së rrjeteve mobile. Pasi që ARKEP ka për qëllim zhvillimin e konkurrencës, mendojmë që hapja e këtyre brezave është e domosdoshme, në mënyrë që operatori i ri eventual me licencë të plotë në Kosovë të ketë mundësi që të jetë konkurrues në treg. Këta tre breza të lartpërmendur ofrojnë bazë për zhvillimin e rrjetave të gjeneratës së dytë, të tretë dhe gjeneratës së katërt në parimin e neutralitetit teknologjik. Brezi 800Mhz është brez i cili është i rëndësishëm për zhvillimin e rrjetave të gjeneratës së katërt, duke siguruar mbulueshmëri më të mirë në krahasim me shumë breza, ndërsa kombinimi i brezave 800 dhe 1800Mhz duke shfrytëzuar funksionalitetin <i>Carrier Aggregation</i>, mund të sigurojë rrjedha të mëdha për shfrytëzuesit fundor. Brezi 2600Mhz, i cili është i specifikuar tek prioriteti i dytë, mendojmë që duhet hapur pasi që të shterohen kapacitetet në breza më të ulët frekuencor. Për hapjen e</p>	<p>ARKEP vlereson se procesi i dhënies së brezeve frekuencore për shërbimet IMT mund të bëhet në tri faza:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Faza e parë: Ripërtrirja e autorizimeve aktuale për operatorët Telekom i Kosovës dhe IPKO lidhur me resurset frekuencore ekzistuese në shfrytëzim në kuadër të brezeve 900 MHz dhe 1800 MHz, sipas mënyrës së drejtpërdrejtë, duke marrë si bazë çmimin “One-Off” të përcaktuar nga ARKEP për dhënien e këtyre kapaciteteve. 2. Faza e dytë: Hapja e brezeve, të cilat nuk janë në shfrytëzim, përfshirë edhe kapacitetet frekuencore në disponim nga operatori me autorizim të përkohshëm mts D.O.O., do t'i nënshtrohet procedurave të tenderit ose ankandit, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Komunikimet Elektronike. Në

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e operatorit mts D.O.O.	Përgjigja e ARKEP
		brezit 3400-3800MHz, i cili do të përdoret për 5G, mendojmë që është ende herët.	<p>këtë fazë do të përfshihen brezet frekuencore 800 MHz, 900 MHz, 1800 MHz, 2100 MHz dhe 2600 MHz.</p> <p>3. Faza e tretë: Përfshinë dhënien e kapaciteteve të pa alokuara frekuencore për shërbimet IMT në kuadër të brezeve: 700 MHz, 3400-3800 MHz dhe 26 GHz.</p>
2	Kur mendoni se është koha më e përshtatshme për iniciimin e procedurës për dhënien në shfrytëzim të këtyre brezeve?	Konsiderojmë që koha kur duhet hapur brezat që i kemi potencuar nën prioritetin e parë (800/900/1800/2100MHz) është fundi i vitit 2018/fillimi i vitit 2019. Brezat tjerë duhet hapur në përputhje me shkallën e zhvillimit të rrjetave në brezat e prioritetit të parë dhe shkallën e shfrytëzueshmërisë së brezave nga prioriteti i parë.	<p>Afatet për iniciimin e procedurës për dhënien resurseve frekuencore do të jetë si në vijim:</p> <p>1. Faza e parë: për dhënien e kapaciteteve frekuencore në brezet 900 MHz dhe 1800 MHz, të cilat aktualisht janë në shfrytëzim nga operatorët Telekom i Kosovës dhe IPKO, ARKEP do të nxjerr vendim të veçantë në gjysmën e parë të vitit 2019, para skadimit të vlefshmërisë së tyre.</p> <p>2. Faza e dytë: Përfshinë dhënien e kapaciteteve frekuencore në brezet tjera që nuk janë në shfrytëzim, përfshirë edhe kapacitetet frekuencore në</p>

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e operatorit mts D.O.O.	Përgjigja e ARKEP
			<p>disponim nga operatori me autorizim të përkohshëm mts D.O.O., do t'i nënshtrohet procedurave të tenderit ose ankandit, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Komunikimet Elektronike. Në këtë fazë do të përfshihen brezet frekuencore 800 MHz, 900 MHz, 1800 MHz, 2100 MHz dhe 2600 MHz. Kjo fazë do të inicohet në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2019.</p> <p>3. Faza e tretë: Përfshinë dhënien e kapaciteteve të pa alokuara frekuencore për shërbimet IMT në kuadër të brezeve: 700MHz, 3400-3800 MHz dhe 26 GHz. Kjo fazë do të inicohet pas vitit 2022.</p> <p>Varësisht nga kërkesa dhe nevoja për zhvillimin e tregut, ARKEP mund të inicioje procedurën për dhënien e kapaciteteve frekuencore në këto breze dhe breze të tjera në përputhje me trendet e zhvillimit të shërbimeve IMT, rekomandimet evropiane dhe me dispozitat ligjore.</p>
3	Cili është kapaciteti frekuencorë që e		Duke pas parasyshë faktin se kërkesat e

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e operatorit mts D.O.O.	Përgjigja e ARKEP
	<p>konsideroni të nevojshëm në kuadër të secilit brez frekuencorë, i cili është me interes për zhvillimin e mëtutjeshëm të rrjeteve mobile brezgjëra?</p>	<p>Shih komentet në shkresën e operatorit</p>	<p>operatorëve në shumicën e brezeve i tejkalojnë kapacitetet e planifikuara, atëherë në përputhje me nevojën për zhvillimin e mëtutjeshëm të shërbimeve mobile brezgjëra, ARKEP do të vleresojë mundësinë e vendosjes së kufizimeve lidhur me kapacitetet frekuencore që mund t'i këtë në dispozicion/apo mund t'i fitojë të drejtën e shfrytëzimit një operator.</p>
4	<p>Cilën nga mënyrat e dhënies në shfrytëzim të brezeve frekuencore (Ankand, Tender, ndarje e drejtpërdrejtë) e konsideroni si më të përshtatshme dhe jepni arsyetimin?</p>	<p>Mendojmë që ankandi (ang. <i>auction</i>) është procedura më e përshtatshme për ndarjen e spektrit, pasi që në këtë mënyrë më së miri nxitet konkurrenca.</p>	<p>Siç kemi theksuar me lartë, ARKEP vlereson se ripërrirja e autorizimeve aktuale për operatorët Telekomit i Kosovës dhe IPKO lidhur me resurset frekuencore ekzistuese në shfrytëzim në kuadër të brezeve 900 MHz dhe 1800 MHz, mund të bëhet sipas mënyrës së drejtpërdrejtë, duke marrë si bazë çmimin minimal për dhënien e këtyre kapaciteteve.</p> <p>Sa i përket brezeve tjera, do t'i nënshtrohen procedurave të tenderit ose ankandit, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Komunikimet Elektronike.</p> <p>Lidhur me hyrjen operatorit të tretë, ARKEP do të merr në konsideratë praktikën me të mira ndërkombetare dhe obligimet nga Marrëveshja e Telekomunikacionit.</p>

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e operatorit mts D.O.O.	Përgjigja e ARKEP
			Poashtu ARKEP do të merr në konsideratë edhe rekomandimet e kompanisë konsulente për vlerësimin e brezeve dhe mënyrën e dhënies së resurseve frekuencore.
5	A e konsideroni si qasje të duhur hapjen e të gjitha brezeve frekuencore të disponueshme?	Mendojmë që është shumë herët për hapjen e brezit 3400-3800MHz.	Duke pasur parasysh objektivat për zhvillimin e mëtutjeshëm të shërbimeve mobile brezgjera, plotësimin e nevojave të tregut, si dhe menaxhimin efikas dhe efektiv të resurseve frekuencore, ARKEP synon hapjen e të gjitha brezeve sipas fazave dhe afateve të specifikuara më lartë (shih më gjerësisht përgjigjen 2 dhe 3).
6	Sa e konsideroni të nevojshëm dhe me interes shfrytëzimin e Teknologjive TDD për shërbime UMTS në të gjitha brezet, por në veçanti në blloqet e pa çiftuara frekuencore 1900–1920 MHz ose 2010–2025 MHz të brezit 2.1 GHz.	Konsiderojmë që nuk është me interes shfrytëzimi i teknologjive TDD për shërbimet UMTS në brezat e lartpërmendur.	ARKEP do të merr parasyshë komentet e operatorëve në planifikimin e ardhshëm të këtij brezi bazuar në rekomandimet evropiane të CEPT/ECC për radio komunikime.
7	Cilat nga brezet frekuencore i konsideroni se duhet të hapen në bllok/paketë?	Konsiderojmë që është e domosdoshme që të hapen në pako brezat 900, 1800 dhe 2100MHz me kapacitete në kuadër të brezave që paraqesin minimumin e nevojshëm për biznes konkurrues të operatorëve. Shembulli i pakos që konsiderojmë që do të jetë e duhura është 900:	Varësisht nga mënyra e dhënies së resurseve frekuencore (tender ose ankand), nevoja për zgjerimin e shërbimeve brezgjëra në tërë territorin e Republikës së Kosovës, nxitjen e investimeve, sigurimi i kualitetit më të mirë të

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e operatorit mts D.O.O.	Përgjigja e ARKEP
		2x8,2MHz, 1800; 2x15MHz, 2100; 2x10MHz. Gjithashtu, konsiderojmë që është e domosdoshme hapja jashtë pakos së kapaciteteve plotësuese në këto breza, si dhe brezin 800MHz, në mënyrë që secili operator të aktivizojë gjerësinë e duhur të spektrit në përputhje me planin për zhvillim të rrjetit dhe shërbimeve.	shërbimeve për konsumatorët, si dhe rritjen mëtutjeshme të konkurrencës efektive në tregun e komunikimeve elektronike, ARKEP do t'a shqyrtoj edhe mundësinë e dhënies në bllok/paketë të brezeve të caktuara frekuencore.
8	Për cilat breze e konsideroni të nevojshme vendosjen e obligimeve për mbulueshmëri?	Konsiderojmë që obligimet për mbulueshmëri duhet të vendosen nga aspekti i disponueshmërisë së shërbimit mobil brezgjërë, pa marr parasysh se me cilin prej brezave të ndarë apo teknologjive të disponueshme IMT operatori ka realizuar mbulueshmërinë.	Në përputhje me praktikat me të mira ndërkombetare, objektivat për zhvillimin dhe shtrirjen e shërbimeve mobile brezgjëra, nxitjen e investimeve në sektor, ARKEP do të shqyrtoj mundësinë e vendosjes së obligimeve për mbulueshmëri. Në veçanti, ARKEP do të shqyrtoj mundësinë e vendosjes së obligimeve për brezet nën 1GHz
9	A mendoni se duhet vendosen obligime për mbulueshmërinë indoor krahas asaj outdoor?	Konsiderojmë që nuk duhet vendosur obligime për mbulueshmëri indoor, sepse ky lloj i kërkesës është shumë i vështirë të definohet, të plotësohet e në fund të kontrollohet në tërë territorin. Varësisht nga lloji i ndërtimit të objektit, dobësimi i sinjalit gjatë kalimit nëpër objekt mund të jetë i lartë dhe në raste të caktuara (p.sh. tek objektet industriale) të kërkojë vendosjen e stacioneve bazë në objekt apo brenda objektit, me të cilën mund të mos pajtohet pronari. Operatorët patjetër do të synojnë mbulueshmëri në këto objekte për të tërhequr dhe/ose mbajtur shfrytëzuesit, por në raste të shumta kjo nuk do të jetë në fuqinë e tyre.	Në përgjithësi, bazuar në praktikat e vendeve evropiane, vendosja e obligimeve indoor nuk aplikohet në shkallë të gjërë. Por, në rast të nevojave për mbulimin e zonave/hapsirave të caktuara me interes më të gjërë për konsumatorët, ARKEP mund të konsideroj si të nevojshme vendosjen e obligimeve për mbulueshmëri indoor.

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e operatorit mts D.O.O.	Përgjigja e ARKEP
10	A e konsideroni të nevojshme vendosjen e kërkesave specifike për mbulueshmëri në viset rurale?	Konsiderojmë që nuk duhet vendosur kërkesa specifike për mbulueshmëri në viset rurale, dhe që përcaktimi i përqindjes së mbulueshmërisë së territorit kërkesë e mjaftueshme.	Shih përgjigjen numër 8.
11	Cili është sugjerimi i juaj lidhur me autorizimet për të drejtën e shfrytëzimit të brezeve frekuencore për shërbimet IMT, validiteti i të cilave pritet të skadojë brenda viteve 2019-2022?	n/a	//
12	A e konsideroni si të domosdoshme vendosjen e kufizimeve lidhur me blloqet frekuencore që mund t'i ketë në dispozicion/fitoj të drejtën e shfrytëzimit një operator?	Kufizimet janë të domosdoshme për ruajtjen e konkurrencës. Meqenëse spektri është një burim i kufizuar, për të mundësuar konkurrencën dhe shfrytëzimin optimal të spektrit, është e domosdoshme vendosja e kufizimeve në kapacitete, dmth. në gjerësi të blloqeve frekuencore që i ndahen një operatori (duke përfshirë edhe spektrin me të cilin ai operator tanimë disponon), e duke pasur parasysh shpërndarjen optimale sipas operatorëve të specifikuar në përgjigjen e dhënë në pyetjen nr. 3.	Me qëllim të krijimit të kushteve të barabarta për të gjithë operatorët dhe menaxhimit efikas dhe efektiv, ARKEP e konsideron si të nevojshme vendosjen e kufizimeve lidhur me blloqet frekuencore që mund t'i ketë në dispozicion/fitoj të drejtën e shfrytëzimit një operator.
13	Komente tjera shtesë	Meqenëse blloqet frekuencore që aktualisht iu janë ndarë mts D.O.O, në bazë të Vendimit nr. 905 dhe Vendimit nr. 936 për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. 905 gjithashtu janë të përfshirë në hapjen e	Lidhur me hyrjen operatorit te tretë, ARKEP do të merr në konsideratë praktikatat me të mira ndërkombetare dhe obligimet nga Marrëveshja

N°	Draft Dokumenti/Pyetja e parashtruar	Komentet e operatorit mts D.O.O.	Përgjigja e ARKEP
		<p>brezave, është e domosdoshme që nën kushtet e procedurës së ndarjes të definohet qartë që këta blloqe mund t'i ndahen ndonjë operatori tjetër vetëm në rast të skadimit të vendimeve të lartpërmendur, siç është përcaktuar në pikën VIII: <i>This decision shall expire once Kosovo Authorities issue a new full/unrestricted mobile telephony authorization as a result of a tender or an auction as it defined in point 4 of Telecommunications Agreement and in accordance with Kosovo Regulatory Framework.</i></p>	<p>e Telekomunikacionit.</p> <p>Poashtu ARKEP do të merr në konsideratë edhe rekomandimet e kompanisë konsulente për vlerësimin e brezave dhe mënyrën e dhënies së resurseve frekuencore.</p> <p>Resurset frekuencore të dhëna në shfrytëzim për operatorin “mts” D.O.O. do të përfshihen në procesin e hapjes së brezave sipas fazave të specifikuar më lartë.</p>